VENDIM
Nr. 509, datë 13.5.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 857, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2 shkronja "b", e 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalia e dytë e pikës 7 të vendimit nr. 857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara sipas kësaj pike, përdoren tërësisht nga qendrat shëndetësore, si pjesë e kostos së shërbimit. Rregullat e veçanta për përdorimin e tyre përcaktohen me udhëzim të këshillit administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.".

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha